

1 E enjte, 16 shkurt 2023

2 [Konferencë para apelit]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari merr pjesë përmes videolidhjes]

5 --- Seanca fillon në orën 9.59

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Mirëmengjes
7 dhe mirë se keni ardhur, të gjithë. Unë jam Gjykatësja Picard,
8 Kryegjykatëse në këtë çështje.

9 Z. Sekretar, ju lutem a mund të thërrisni çështjen.

10 SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, kjo
11 është lënda me numër KSC-CA-2023-02, Prokuroria e Specializuar
12 kundër Salih Mustafës.

13 Faleminderit.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Do ju
15 kërkoj palëve që të prezantohen, duke filluar nga Zyra e
16 Prokurorit të Specializuar.

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mirëmengjes, e nderuar
18 Gjykatëse. Mirëmengjes, të gjithëve këtu në sallën e gjyqit
19 dhe jashtë saj. ZPS-ja përfaqësohet sot nga z. Nathan Quick,
20 Julie Mann që është Menaxhere e Çështjes dhe unë jam z.
21 Michalczuk, Prokuror i ZPS-së.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]

23 Faleminderit.

24 Tani më lejoni t'i kthehem Mbrojtjes. Mbrojtja, ju lutem
25 prezantohuni.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata e Apelit

Konferencë para apelit (Seancë e hapur)

Faqe 2

1 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëmëngjes, e nderuar. Unë jam
2 z. Julius Von Bone. Jam Mbrojtja e të akuzuarit dhe z. Rees
3 është po ashtu bashkëmbrojtës. Ndërkohë që z. Mustafa na ndjek
4 përmes videolidhjes. Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]
6 Faleminderit.

7 Vazhdojmë me Mbrojtjen për Viktimat. Ju lutem
8 prezantohuni.

9 ZNJ. PUES: [Përkthim] Mirëmëngjes, e nderuar Gjykatëse.
10 Mirëmëngjes, të gjithëve. Ndërkohë përfaqësuesit e viktimave
11 jemi unë, Anni Pues dhe znj. Vossenberg që është
12 bashkëmbrojtëse.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]
14 Faleminderit.

15 Zyra Administrative.

16 Z. ROCHE: [Përkthim] Mirëmëngjes, e nderuar Gjykatëse.
17 Unë jam Ralph Roche nga Zyra administrative.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Vërej që z.
19 Mustafa nuk është i pranishëm këtu në sallë por e ndjek
20 seancën përmes videolidhjes.

21 Përpara sesa të fillojmë, dëshiroj t'ju kujtoj se
22 Gjykatësi Ambos, Gjykatësja Jorgensen dhe unë jemi caktuar nga
23 Gjykata e Apelit që të vendosim për apelin kundër aktgjykimit
24 të nxjerrë për këtë çështje më datë 16 dhjetor 2022. Në
25 përputhje me rregullën 178 të Rregullores, qëllimi i kësaj

1 konference para apeli është për t'i dhënë mundësi të akuzuarit
2 që të ngrejë çështje që kanë të bëjnë me ndalimin e tij,
3 përfshirë këtu dhe gjendjen mendore dhe fizike. Për këtë
4 qëllim, më datë 9 shkurt 2023, kam nxjerrë një urdhër në emër
5 të Trupit Gjykses për të organizuar këtë konferencë para apeli
6 dhe për të përcaktuar rendin e ditës që do të realizohet sot.

7 Për seancën e ditës së sotme, dëshiroj t'ju kujtoj të
8 gjithëve që duhet të respektohen disa rregulla gjatë gjithë
9 kohës në mënyrë të tillë që të kemi seancë efektive me
10 procesverbal të saktë.

11 Mbani parasysh nevojën e përkthimit të saktë, gjë që
12 kërkon pak më shumë kohë shtesë pasi ju të keni përfunduar së
13 foluri. Ju lutem ngrihuni në këmbë për të kërkuar leje për të
14 folur dhe mos harroni që ndizni mikrofonin.

15 Kjo seancë zbardhet në kohë reale dhe do të reflektohet
16 në transkriptin që është i disponueshëm për publikun.

17 Ju kujtoj Mbrojtjes që të japë njoftim paraprak në qoftë
18 se ndonjë parashtrim kërkon nxjerrjen e informacionit
19 konfidencial në mënyrë të tillë që të mund të kalojmë në
20 seancë private ose të mbyllur.

21 Sikurse përcaktohet në Urdhrin për Planifikimin e Seancës
22 edhe në rendin e ditës për sot, së pari do të dëgjojmë
23 parashtrime lidhur me ndalimin e të akuzuarit. Informoj
24 gjithashtu Administratoren që dëshiroj që të dëgjojmë
25 parashtrime që kanë të bëjnë me ecurinë e përkthimit të

1 aktgjykimit në gjuhën shqipe dhe kur planifikohet që të
2 përfundohet përkthimi.

3 Vërej se Mbrojtja e Viktimave ka kërkuar që të diskutohet
4 në konferencën para apelit fusha e veprimit të parashtrimeve
5 që mund të bëhet prej saj gjatë proceseve të apelit. Po ashtu
6 Mbrojtja ka dorëzuar një mocion lidhur me këtë temë. Dhe duke
7 marrë parasysh vendimin e Trupit Gjykses që përcakton
8 modalitetet e pjesëmarrjes së viktimave gjatë proceseve të
9 apelit, nuk kërkohen parashtrime të tjera.

10 Nuk e di në qoftë se keni pasur kohë për ta lexuar këtë
11 vendim apo jo.

12 Mbrojtja për z. Mustafa nuk e ka informuar Trupin Gjykses
13 për asnjë çështje shtesë që do të trajtohet sot. Vërej
14 gjithashtu që ZPS-ja nuk dëshiron që të ngrejë ndonjë çështje
15 shtesë. Seanca e ditës së sotme do të realizohet në përputhje
16 me rendin e ditës.

17 Për rrjedhojë, unë ftoj Mbrojtjen tani të ngrejë ndonjë
18 çështje që ka të bëjë me ndalimin e të akuzuarit. I kujtoj
19 Mbrojtjes që të kërkojë që të kalojmë në seancë private nëse
20 dëshirojnë që të drejtohen apo të përdorin ndonjë informacion
21 konfidencial që ka të bëjë me gjendjen shëndetësore ose
22 mjekësore të të akuzuarit.

23 Tani, Mbrojtja e z. Mustafa, e keni fjalën ju për të
24 vijuar.

25 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar

1 Gjykatëse. Procesi i apelit kërkohet sepse i akuzuari, pra,
2 Mbrojtja e të akuzuarit kundërshton vendimin e Trupit Gjykues
3 më datë 16 dhjetor.

4 Sa i takon rendit të ditës së sotme për ndalimin në apel,
5 ne nuk dëshirojmë që të ngremë asnjë çështje në këtë pikë. Në
6 qoftë se do ta bëjmë këtë gjë më vonë, do ta realizojmë përmes
7 një mocioni të veçantë përgjatë procesit gjyqësor të apelit,
8 por që nuk do ta ngremë këtë çështje sot, pra, në këtë seancë.

9 Kështu që nuk kemi asnjë çështje pezull lidhur me këtë
10 temë.

11 Shumë faleminderit.

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, sa i takon
13 ndalimit, pozicioni ynë është që i akuzuari ose i dënuari
14 duhet të vazhdojë që të qëndrojë i ndaluar. Pra, ka një dyshim
15 të arsyeshëm, të besuar dhe pragu është edhe më i lartë pas
16 dënimit në përputhje me nenin 41, paragrafi 6(a). Ka rrezik që
17 jo vetëm sa i takon pengimit të procesit penal përpara kësaj
18 Dhome të Specializuar por gjithashtu edhe rreziku i largimit.
19 Sepse pas dënimit me 26 vite heqje lirie për z. Mustafaj, për
20 vrasje të paligjshme, torturë dhe ndalim arbitrar, ne besojmë
21 se përveç rreziqeve që janë konfirmuar nga Trupi Gjykues edhe
22 rreziku i largimit nga z. Mustafa janë të pranishëm në këtë
23 rast.

24 Të nderuar Gjykatës, ne besojmë se në pajtim me nenin 48
25 [sipas përkthimit], paragrafi 8, të Ligjit për ZPS-në dhe

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata e Apelit

Konferencë para apelit (Seancë e hapur)

Page 6

1 Dhomat e Specializuara, ndalimi, mbajtja në ndalim është
2 rregulli dhe jo përjashtimi. Dhe në vendimin e Apelit në
3 çështjen kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt, që është
4 vendim i datës 28 korrik 2022, u konfirmua që, në fakt,
5 ekziston prezumimi për mbajtje në ndalim gjatë procedurave të
6 apelit dhe lirimi është përjashtimi dhe jo rregulli.

7 Pra, ky është pozicioni i Prokurorisë dhe, me fjalë të
8 tjera, ne si Prokurori i mbetemi pozicionit se z. Mustafa
9 duhet të mbetet në ndalim gjatë kësaj periudhe.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Në emër të
11 Trupit Gjykses, unë kujtoj që në përputhje me nenin 46(8) të
12 Ligjit, me përjashtim të rastit kur Trupi Gjykses ose Trupi
13 Gjykses i Apelit urdhëron ndryshe, një person i dënues duhet
14 të mbetet në ndalim gjatë procesit të apelit. Kujtoj më tej
15 konstatimin e Trupit Gjykses, në KSC-CA-2022-01, se ndryshe
16 nga faza përgatitore ose faza përpara dënimit në nivel të parë
17 ose në shkallë të parë ku Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose
18 Trupi Gjykses kërkohet që të bëjë një rishikim njëherë dy muaj
19 për ndalimit, sipas rregullave të Procedurave dhe Provave dhe
20 Ligjit, kjo nuk kërkohet më në procesin e apelit.

21 Pika tjetër e rendit të ditës ka të bëjë me ecurinë e
22 bërë lidhur me përkthimin e aktgjykimit në shqipe.

23 Ju lutem, a mund të na informojë lidhur me këtë çështje
24 Zyra Administrative.

25 Z. ROCHE: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata e Apelit

Konferencë para apelit (Seancë e hapur)

Faqe 7

1 Versioni paraparak i përkthimit është dorëzuar sot, ndërkohë që
2 planifikojmë që versionin e rishikuar dhe përfundimtarin
3 përkthimit të jetë gati jo më vonë sesa data 30 mars 2023. Do
4 të shpërndajmë versionin përfundimtar, pra, në fund të marsit.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Në rregull.

6 Kemi ndonjë koment apo ka ndonjë konstatim të veçantë nga
7 palët lidhur me këtë pikë?

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse. Dëgjoj
9 që është shpërndarë sot. Po kam përshtypjen që e kam marrë të
10 mërkurën. Por është versionin e parishikuar, ka shënime me të
11 verdhë në të dhe dëgjoj që versionin përfundimtar do të jetë në
12 fund të marsit, me çka kuptova.

13 Është e rëndësishme që të kemi versionin të mirë dhe
14 përfundimtar, në veçanti për të akuzuarin, sepse mendoj që
15 padiskutim që i akuzuari e dëshiron që të kontribuojë për
16 shkaqet e apelit. Ne kemi dorëzuar nëntë shkaqet e apelit.
17 Ndërkohë që z. Mustafa nuk ka pasur mundësi që të shohë
18 vendimin dhe ka lexuar vetëm versionin në anglisht, por
19 ndërkohë anglishtja nuk është gjuha e tij e nënës. Kështu që
20 nuk mendojmë që duhet të jetë kështu sepse është e rëndësishme
21 që i akuzuari të ketë mundësi që të formulojë dhe arsyet e
22 veta të apelit, kështu që për ne është e rëndësishme që
23 versionin e rishikuar dhe përfundimtarin e aktakuzës të dorëzohet
24 sa më shpejtë.

25 Thënë kjo, ne nuk përjashtojmë që në atë kohë, pra, kur

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata e Apelit

Konferencë para apelit (Seancë e hapur)

Page 8

1 të bëhet kjo gjë, kur të dorëzohet versioni përfundimtar i
2 aktgjykimit, ne mund të dorëzojmë arsye të tjera shtesë
3 apelimi sepse, sikurse e thashë, deri tani i akuzuari nuk ka
4 pasur mundësi që të lexojë aktakuzën e plotë.

5 Kështu që për këtë arsye, më lejoni të theksoj edhe një
6 herë tjetër që mendoj që është e arsyeshme dhe e rëndësishme
7 për të akuzuarin që versioni përfundimtar i përkthimit të
8 vijë. Dëgjova që do të dorëzohet në fund të marsit. Do të
9 preferoja që të dorëzohet pak më herët sepse vendimi është
10 marrë në dhjetor, kështu që pretendonim dhe shpresonim që
11 vendimi të mund të ishte i përkthyer përpara kësaj periudhe.

12 Faleminderit.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Në rregull.
14 E mbajtmë shënim shqetësimin tuaj, e kuptojmë që do të keni
15 shumë pak kohë nga momenti kur do të merrni versionin
16 përfundimtar të aktgjykimit në shqip dhe kohës kur duhet të
17 dorëzoni dosjen tuaj të apelit. Por, nëse është e nevojshme,
18 mund të dorëzoni parashtrime me shkrim për t'i kërkuar Trupit
19 Gjykses për shtyrë afatin për dorëzimin e dosjes së apelit.

20 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, padiskutim po e mendojmë këtë
21 si mundësi për shkak të këtij aspekti. Për këtë arsye e
22 ngrita.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] E kuptoj.

24 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Sa i takon

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata e Apelit

Konferencë para apelit (Seancë e hapur)

Faqe 9

1 dosjeve dhe dorëzimit të dosjeve të apelit, përgjigjeve dhe
2 kundërpërgjigjeve, në emër të Trupit Gjykues, dua t'u kujtoj
3 palëve dhe Mbrojtjes së Viktimave që dosjet e apelit,
4 përgjigjet dhe kundërpërgjigjet, duhet të jenë në përputhje me
5 numrin e lejuar të fjalëve, siç tregohet dhe sikurse
6 parashikohet në udhëzuesin e punës së Zyrës Administrative për
7 dosjet dhe parashtrimet e protokolluara.

8 Sikurse parashikohet në këtë udhëzues, numri i lejuar i
9 fjalëve për dosjet e apelit janë 30.000 fjalë.

10 Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, a mundem të
11 flas?

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Po.

13 Z. VON BONE: [Përkthim] Ju sapo iu referuat numrit të
14 lejuar të fjalëve. Ndërkohë që thashë që kemi nëntë arsye për
15 apel por ka edhe shumë -- kemi ndoshta 59 ose 60 nënarsye,
16 kështu që mund të na duhen më shumë fjalë. Kështu që
17 parashikoj që mbase do t'ju kërkojmë që të shtohet numri i
18 lejuar i fjalëve, në mënyrë të tillë që të trajtojmë,
19 domethënë, të mund të bëjmë dosjen tonë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Me ç'kuptoj
21 do të bëni një kërkesë lidhur me këtë pikë apo jo?

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Po.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Mirë,
24 atëherë kur të jetë koha e përshtatshme do të vendosë Trupi
25 Gjykues.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata e Apelit

Konferencë para apelit (Seancë e hapur)

Faqe 10

1 Në qoftë se nuk ka ndonjë gjë tjetër për të shtuar, këtu
2 është fundi i seancës së ditës së sotme. Më lejoni të
3 falënderoj palët, po ashtu edhe Mbrojtjen e Viktimave, Zyrën
4 Administrative për praninë dhe kontributet e tyre. Më lejoni
5 gjithashtu të falënderoj përkthyesit, stenografët, teknikët
6 audiovizivë dhe personelin e sigurisë për ndihmën e tyre.

7 Seanca mbyllet këtu.

8 --- Seanca mbyllet në orën 10.15

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25